# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-426329**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Këtu nuk ka rregulla, s'është si te Mercedesi"/ Hamilton 'shpërthen' ndaj Ferrarit dhe Leclerc: Tani kampionati për mua mbaroi |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/07/ketu-nuk-ka-rregulla-seshte-si-te-mercedes-i-hamilton-shperthen-ndaj-ferrarit-dhe-leclerc-tani-kampionati-per-mua-mbaroi/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 07:17:48 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 7 shtator 2026, 07:15:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 7 shtator 2026, 07:14:00 UTC → 7 shtator 2026, 07:16:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `89835295d498afb9d1622999c1c006ecd2a2200b6a5c5306f680dd34db84d536` |
| TEKSTI | `0ee2b4168c270190b31c728e91c1eef470fb38ee41770db45138f3d80ebadc1c` |
| PAMJA | `fd7812b2bca65995491e80a2d6fa1786e940924bbe87fdf58829380f1b36d36f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `58ade20d958a0fafdab51ea4105760d3d1ef919a953240878a10e02a87c28595` |
| E MËPARSHMJA | `fb751f279bf40e36912ceabea951eda97876f7b5e88fa5aa01517e28b403e62b` |
| RRËNJA MERKLE | `8275cf7c36f2fb6eda987993887bc0a61b2302660f4011ea7026d332154683fb` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/58ade20d958a0fafdab51ea4105760d3d1ef919a953240878a10e02a87c28595`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# “Këtu nuk ka rregulla, s’është si te Mercedesi”/ Hamilton ‘shpërthen’ ndaj Ferrarit dhe Leclerc: Tani kampionati për mua mbaroi

07/09/2026 09:15

Lewis Hamilton ka pranuar se shanset e tij për titullin kampion në Formula 1 janë pothuajse shuar, ndërsa pas Çmimit të Madh të Italisë kritikat e tij ndaj Ferrarit dhe Charles Leclerc u bënë edhe më të forta.

Gara në Monza rezultoi një tjetër zhgënjim për shtatë herë kampionin e botës. Hamilton e përfundoi garën vetëm në vendin e gjashtë, ndërsa bashkëpiloti i tij Charles Leclerc u tërhoq pas një aksidenti të rëndë në xhiron e dytë. Por problemet për Hamilton nisën që në xhiron e parë.

Në kthesën e parë të shikanës, britaniku tentoi të parakalonte Leclerc, por u shty jashtë piste dhe humbi disa pozicione, duke zbritur deri në vendin e 10-të. Hamilton ishte i bindur se Leclerc nuk i la hapësirën e nevojshme.

Pas garës, ai nuk e fshehu zhgënjimin dhe drejtoi gishtin edhe nga drejtuesi i Ferrarit, Fred Vasseur.

*“Unë nuk garoj pisët. Gjithmonë kam garuar pastër dhe me drejtësi dhe gjithmonë kam lënë hapësirë.”*

Hamilton shtoi se problemi, sipas tij, nuk qëndron vetëm te pilotët, por nis nga drejtimi i skuadrës.

*“Në fund të fundit, kjo vjen nga lart. Fillon me Fred-in dhe pastaj përcillet poshtë.”*

Situata në kampionatin botëror është përkeqësuar ndjeshëm për Hamilton. Pas Monzës, ai ndodhet 76 pikë pas Kimi Antonellit, i cili triumfoi në mënyrë spektakolare në garën italiane, pasi ishte nisur nga vendi i 19-të.

Me vetëm 10 gara të mbetura, Hamilton beson se Ferrari ka humbur shumë kohë duke mos marrë vendime më të qarta për menaxhimin e dy pilotëve.

*“Është shumë vonë për ato vendime. Shumë, shumë javë vonë”*, deklaroi Hamilton, duke iu referuar mundësisë që Ferrari ta kishte favorizuar më herët në luftën për titull.

Britaniku pranoi se diferenca me Antonellin, së bashku me ritmin e Mercedes, e bën rikthimin në garën për titull jashtëzakonisht të vështirë.

Një nga kritikat më të forta të Hamilton ishte mungesa e rregullave të qarta mes pilotëve të Ferrarit.

Ai e krahasoi situatën me periudhën e tij te Mercedes, ku, sipas tij, skuadra kishte rregulla të përcaktuara qartë për mënyrën se si duhej të silleshin pilotët gjatë garave.

*“Kur isha te Mercedes, kishim rregulla të shkruara për mënyrën se si duhej të garonim. Këtu nuk ka rregulla. Kjo është diçka që ndoshta duhet të ndryshojë”*, tha Hamilton.

Kritikat vijnë në një moment delikat për Ferrarin. Leclerc tashmë ndodhet 112 pikë pas Antonellit, ndërsa pas rezultatit të Monzës, vetë Vasseur pranoi se skuadra mund të marrë në konsideratë favorizimin e Hamiltonit në garat e ardhshme.

*“Rezultati i kthesave një-dy nuk është i mirë për skuadrën”*, tha Vasseur.

Ai la të kuptohet se Ferrari tani mund të duhet të marrë një vendim më të qartë për prioritetet e saj në kampionat.

Ndërkohë, Kimi Antonelli shkroi historinë në Monza duke fituar Çmimin e Madh të Italisë pas një rikthimi të jashtëzakonshëm nga vendi i 19-të në nisje.

Piloti i Mercedesit u ngjit në majë të podiumit përpara shokut të skuadrës George Russell dhe Max Verstappen të Red Bull.

**Top Channel**

Formula 1 »
Pranga ish-bosit legjendar të Formula 1, 95-vjeçari u ndalua në aeroport me një armë gjahu në valixhe
07/09 15:44
Formula 1/ Arritja tjetër e Antonellit, bëri tifozët e Ferrarit të festojnë fitoren e tij në Monza
06/09 22:25
Formula 1/ Magji e Antonelli-t në Monza, piloti italian niset nga vendi i 19-të dhe fiton garën, lë pas Russell dhe Verstappen
06/09 16:55
Formula 1/ Surprizë në provat zyrtare të Monzës, Pierre Gasly merr pole position, lë pas Russell dhe Paistrin
05/09 17:09
Ferrari ëndërron në Monza/ Leclerc dhe Hamilton më të shpejtët në provat e lira, lënë pas Mercedesin
04/09 13:46
Formula 1/ Nga torta te salca djegëse, lufta e çmendur mes Kimit dhe Bono-s te skuadra Mercedes
03/09 15:54
Kryesore »
“Më zunë pritë me sharje dhe fyerje”/ Iris Luarasi flet për incidentin para hyrjes në Parlament: Më akuzuan se nuk mbroj gratë, ndërkohë që…
08/09 19:44
Bllokimi i pagave dhe zbatimi i vendimit të Kushtetueses, gjyqtarët mbledhje urgjente më 10 shtator
08/09 19:34
LIVE/ Një orë seancë mes vezëve dhe përplasjeve të forta jashtë Parlamentit, protestuesit bllokojnë rrugët, policia i arreston, pranga edhe Lapajt
08/09 19:02
Protestuesit bllokojnë rrugët në kryeqytet, Policia tenton t’i largojë, shoqëron edhe disa tubues të tjerë
08/09 18:57
Dokumentacionet e pronësisë në Palasë, Kadastra paralajmëron: Nga nesër nis kontrolli derë më derë
08/09 18:51
Tensionet në protestën jashtë Kuvendit, policia shoqëron Adriatik Lapajn
08/09 18:38
Shumësportësh »
Pranga ish-bosit legjendar të Formula 1, 95-vjeçari u ndalua në aeroport me një armë gjahu në valixhe
07/09 15:44
Tronditet bota e wrestling, ndahet papritur nga jeta mundësi i njohur pas kolapsit gjatë ndeshjes
07/09 10:05
Formula 1/ Arritja tjetër e Antonellit, bëri tifozët e Ferrarit të festojnë fitoren e tij në Monza
06/09 22:25
Formula 1/ Magji e Antonelli-t në Monza, piloti italian niset nga vendi i 19-të dhe fiton garën, lë pas Russell dhe Verstappen
06/09 16:55
Tragjedi në Rally Mille Miglia, makina del nga rruga dhe përplas për vdekje një spektator në Brescia
05/09 21:42
Formula 1/ Surprizë në provat zyrtare të Monzës, Pierre Gasly merr pole position, lë pas Russell dhe Paistrin
05/09 17:09
Sport »
Yamal dhe ‘Topi i Artë’: Nuk do të lutem të ma japin, objektivi kryesor, Champions League
08/09 18:46
Champions League/Luis Enrique: PSG në krizë? Nuk jam i shqetësuar, por duhet të përmirësohemi
08/09 18:15
Nga Kane e Yamal te Rodri dhe Messi, publikohet lista me 30 kandidatët për Topin e Artë 2026/ Shumë emra surprizë, por mungon Raphinha
08/09 16:40
Top Channel sjell surprizën e madhe, Igli Tare bëhet analist i Champions League
08/09 15:28
Como debuton në Champions League, drejtuesit e klubit bëjnë gjestin për t’u duartrokitur për tifozët
08/09 14:18
HISTORIKE/ Një shqiptare në ceremoninë e ‘Topit të Artë’, Elena Sadiku, e vetmja trajnere femër në pesëshen finaliste
08/09 13:33
Na ndiqni:
Top Channel Top Channel ***F1*** @topchannelalbania Top Channel
Video »
Top Channel/ Kadastra, derë më derë në Palasë! Kontroll për banesat pa dokumentacion
Top Channel/ Financimi i grave sipërmarrëse, Kodi për mbështetjen e atyre që menaxhojnë kompani
Top Channel/ “Na kontrollojnë dhe të brendshmet”! Avokatët nisin bojkotin për rregulloren e re

Top News- “Lëshojeni…”, Adriatik Lapaj dhe gazetari Shpend Gashi merren me forcë nga policia
Top Channel/“Na kontrollojnë deri te të brendshmet”, Saimir Visha: Në cilin vend të botës ndodh kjo
Top Channel/ Përparim Sanxhaku kundër bojkotit: Çfarë do fitojmë? Do ta çojmë në pafundësi?
Sport • KRYESORE
Top Channel sjell surprizën e madhe, Igli Tare bëhet analist i Champions League
E konfirmon klubi i tij, Ylber Ramadani merr ftesën e Kombëtares për ndeshjet e Nations League
Zyrtare/ Dinamo përforcon mbrojtjen, prezanton futbollistin 20 vjeçar nga Nigeria
Champions League/Luis Enrique: PSG në krizë? Nuk jam i shqetësuar, por duhet të përmirësohemi
Champions League në Top Channel/ Napoli-Arsenal, supersfida e parë që vjen në ekranin më të dashur të shqiptarëve
Me të lexuarat
Top Channel sjell surprizën e madhe, Igli Tare bëhet analist i Champions League
Champions League në Top Channel/ Moderon Edi Manushi, zbulohen detajet e emisionit para dhe pas ndeshjeve
HISTORIKE/ Një shqiptare në ceremoninë e ‘Topit të Artë’, Elena Sadiku, e vetmja trajnere femër në pesëshen finaliste
E konfirmon klubi i tij, Ylber Ramadani merr ftesën e Kombëtares për ndeshjet e Nations League
Bayernin e zënë “ethet” për Olise, drejtuesit nuk e garantojnë të ardhmen e yllit francez. Real Madrid gati të ndërhyjë
Nga Kane e Yamal te Rodri dhe Messi, publikohet lista me 30 kandidatët për Topin e Artë 2026/ Shumë emra surprizë, por mungon Raphinha
Objektivi ‘Metropolitano’/ Nis sot Champions League, të gjithë kundër Paris Saint Germainit
Como debuton në Champions League, drejtuesit e klubit bëjnë gjestin për t’u duartrokitur për tifozët
Champions League/ Interi në sfidën delikate me Real Madrid, historiku i përballjeve mes gjigantëve evropianë të futbollit
Nis Champions League/ Direktivat e reja arbitrare, më pak VAR dhe pa ‘ligjin Prestianni’



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.